



Shqiperia e 17-vjecareve e ka nisur me humbje fazen eliminatore te Euro 2015. Ndeshja e pare e luajtur ne Korce ka perfunduar me rezultatin 0-1 per skuadren e Rumanise. Djelmoshat e Xhemal Mustedanagic kane bere nje ndeshje te mire me ritem te larte por nuk arriten te merrnin fitoren e shume deshruar. Nje numer I madh spektatoresh, prinderish dhe njerezish te interesuar per te pare lojtaret e rinj ne moshe kane qene te pranishem ne stadiumin "Skenderbeu". Ne pjesen e pare Zoizi, mesfushori shqiptar qe luan per Breshian ne Itali ishte prane golit por gabo i ne finalizim. Edhe Bakalli njesoj si ai dhe Shqiperia humbi dy mundesi mjaft te mira. Ne pjesen e dyte serish loja nisi njesoj me kuqezinjte ne sulm dhe rumunet ne mbrojtje. Nje kundersizim I miqve solli golin e pare dhe te vetem takimit I shenuar nga Ivan. Rezultati deri ne fund mbeti I pandryshuar dhe rumunet ne Korce moren tre piket qe u duheshin. Me kete humbje, Shqiperia e nis ne menyren me te keqe fazen kualifikuese qe do te zhvillohet ne vendin tone. Ne grupin 1 bejne pjese edhe Bjellorusia e Finlanda te cilat u ndeshen ne qytetin e Pogradecit dhe e mbyllen 80 minuteshin ne favor te bjelloruseve. Faza e pare e eliminatorëve parashikon 6 ndeshje ku 2 skuadrat e para te grupit do te kualifikohen per ne "Elite Round"